

Shpallje

Termtat e Referencës

<u>Organizata</u>	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar)
<u>Qëllimi i Angazhimit</u>	Qëllimi i angazhimit të ekspertit është të ofrojë mbështetje profesionale në rishikimin, përditësimin dhe harmonizimin e rregulloreve ekzistuese të Handikos Ferizaj, përmes konsultimit me stafin dhe përgatitjes së versioneve të përditësuara të dokumenteve, në mënyrë që ato të jenë të qarta, funksionale dhe në përputhje me nevojat aktuale të organizatës. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Grant Institucional EJA- GI- 15” , i mbështetur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’ dhe bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia .
<u>Tipi</u>	Individuale/ Kompani
<u>Lokacioni</u>	Ferizaj, Kosovë
<u>Kohëzgjatja</u>	3 ditë

Handikos Ferizaj

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Handikos-Ferizaj, punon për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri si dhe aktivisht lobon dhe mbron në nivel lokal të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i angazhimit është rishikimi, përditësimi dhe harmonizimi i rregulloreve ekzistuese të Handikos Ferizaj, me synim që ato të pasqyrojnë më mirë mënyrën aktuale të funksionimit të organizatës, procedurat e brendshme dhe nevojat institucionale, duke kontribuar në një funksionim më të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm të organizatës.

Një (1) Ekspert/e lokal:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrtimi dhe analiza e rregulloreve ekzistuese të Handikos Ferizaj;
- Identifikimi i nevojave për ndryshime, plotësime dhe përditësime;
- Zhvillimi i një punëtorie me stafin për diskutimin e rregulloreve dhe mbledhjen e propozimeve;
- Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores Financiare dhe të Prokurimit;
- Rishikimi dhe harmonizimi i Rregullores së Kuvendit të Anëtarëve;
- Rishikimi dhe harmonizimi i Rregullores së Bordit;
- Përfshirja e rekomandimeve dhe komenteve të dala nga punëtorja;
- Përgatitja e versioneve finale dhe të konsoliduara të rregulloreve;
- Dorëzimi i dokumenteve të finalizuara te Handikos Ferizaj.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, menaxhim, ekonomi ose fusha të ngjashme;
- Përvojë profesionale në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e rregulloreve dhe dokumenteve institucionale;
- Njohuri të mira mbi procedurat administrative, financiare dhe të prokurimit;
- Përvojë në punën me organizata joqeveritare dhe/ose organizata të shoqërisë civile konsiderohet përparësi;
- Përvojë në zhvillimin e punëtorive dhe konsultimeve me staf dhe struktura drejtuese;
- Aftësi të mira analitike, komunikuese dhe përgatitëse të dokumenteve;
- Aftësi për të integruar komentet dhe rekomandimet e palëve të përfshira në dokumentet finale.

Kohëzgjatja dhe pritjet

Angazhimi do të realizohet brenda **3 ditëve të punës**, ku një ditë do t'i kushtohet zhvillimit të punëtorisë fizike me stafin e Handikos Ferizaj, ndërsa dy ditë do t'i kushtohen rishikimit, përditësimin, harmonizimit dhe finalizimit të rregulloreve ekzistuese. Nga eksperti/ekspertja pritët përfundimi dhe dorëzimi i versioneve të përditësuara dhe të konsoliduara të dokumenteve, në përputhje me nevojat dhe rekomandimet e dakorduara gjatë punëtorisë.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Draft-propozim mbi metodologjinë e punës, duke përfshirë edhe koston financiare të kalkuluar për ditët e angazhimit.
- Letër interesi, që shpjegon arsyet pse aplikuesi/ja është i/e përshtatshëm/e dhe evidenton njohuritë dhe eksperiencën relevante në fusha të ngjashme.
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar, duke përfshirë përvojën profesionale dhe arsimore.

Pagesa

Pagesa për Ekspert/e, do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësi të kontraktuar;

Procedurat e aplikimit:

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në adresën e-mail:

prokurimihandikos@gmail.com, me subjektin: "Aplikoj për [emri i pozitës që aplikoni]".

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **04.09.2026 ora 23:59**

Vetëm kandidatët që përzgjidhen për listën e ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit, informacione të mëtejshme nuk ofrohen përmes telefonit.